



**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
(MM)**

NË MES TË

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN

DHE

**ODËS SE AVOKATËVE TË KOSOVËS
(OAK)**

DHE

**PROGRAMIT "KËRKO DREJTËSI"
(D4J)**

**LIDHUR ME
ZHVILLIMIN E KLINIKËS JURIDIKE PENALE ME RASTE REALE**

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Programit "Kërko Drejtësi" për të bashkëpunuar me Fakultetin Juridik të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Odën e Avokatëve të Kosovës, me qëllim të institucionalizimit dhe zgjerimit të trajnimit për shkathtësi praktike për studentët e juridikut; dhe

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan për të siguruar arsimin cilësor për studentët në bazë të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe zhvillimit të shkathtësive profesionale praktike;

Palët pajtohen si në vijim:

**Neni 1
Qëllimi**

1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është të lehtësojë bashkëpunimin midis Programit "Kërko Drejtësi", Odës së Avokatëve dhe Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan për të ndihmuar zhvillimin e Klinikës Juridike Penale me raste reale me qëllim të rritjes së cilësisë së arsimit juridik në Kosovë duke zgjeruar disponueshmërinë e trajnimit për shkathtësi praktike.

Neni 2

Veprimet e Programit "Kërko Drejtësi"

2.1 D4J, përmes zbatimit të programit të tij nga National Center for State Courts (NCSC), ka për qëllim të ndihmojë Fakultetin Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan në zhvillimin e Klinikës Juridike Penale me raste reale. D4J synon të vë në dispozicion të Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan ekspertizën e fituar përmes pilot klinikës të programit D4J të zhvilluar në Prishtinë me ndihmën e avokatëve *pro-bono* të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë.

2.2 D4J synon të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të strukturës së Klinikës Juridike Penale të Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan. D4J gjithashtu ka për qëllim të ofrojë ndihmë në zhvillimin e doracakut operacional dhe të programit mësimor për Klinikën Juridike Penale me raste reale.

2.3 D4J synon të mbështesë Fakultetin Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan me ndihmë financiare për pagesën e pagës së koordinаторit të Klinikës Juridike Penale për periudhën nga data e themelimit të Klinikës deri më 31 maj 2018.

2.4 Paga bruto e koordinаторit është 300 (treqind) euro. Paga do të paguhet nga data 1 deri më datën 5 të çdo muaji, duke zbritur tatimet dhe ndalesat tjera të detyrueshme që do të paguhet drejtpërdrejtë te organet kompetente.

2.5 D4J synon të sigurojë një student praktikant me gjysmë-orari për të mbështetur personelin e Klinikës Juridike Penale. D4J do të ofrojë ndihmë financiare për praktikantët në shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro bruto në muaj. Përzgjedhja e praktikantit do të bëhet nga D4J.

Neni 3

Veprimet e Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan

3.1 Fakulteti Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan njihet si partnerin e tij kryesor në lehtësimin e ofrimit të arsimit më të mirë të shkathtësive praktike për studentët dhe në rritjen e përqindjes së studentëve që vijnë në lëndë juridike klinike.

3.2 Nga Fakulteti Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan pritet të mundësojë zgjerimin, thellimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të lëndës Klinikës Juridike Penale me raste reale. Ligjëratat do të mbahen në objektet e Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan.



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



3.3 Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan do të emërojë një koordinator të Klinikës Juridike Penale me raste reale. Ky emërim do të hyj në fuqi, më së voni, në ditën e nënshkrimit të këtij MM-je.

3.4 Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan do të sigurojë të hapësirën (sallën) ku duhet zhvilluar Klinika përgjatë sesioneve ditore (12 ligjëratave). Kjo hapësirë do të vihet në dispozicion, më së voni, në ditën e nënshkrimit të këtij MM-je.

3.5 Koordinatori do t'i dërgojë NCSC-së, të hënën e parë të çdo muaji deri më 31 maj 2018, një raport për aktivitetet mujore që dokumenton me të dhëna të hollësishme përparimin e arritur në zhvillimin e Klinikës Juridike Penale me raste reale.

3.6 Mbikëqyrësi i nivelit të parë të koordinatorit të Klinikës Juridike Penale do të jetë dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan. Detyrat e koordinatorit të Klinikës Juridike Penale dhe personelit të Klinikës do të përcaktohen në doracakun e Klinikës Juridike Penale i cili do të hartohet bashkërisht nga Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan dhe D4J.

Neni 4

Veprimet e Odës së Avokatëve të Kosovës

4.1 OAK synon të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të strukturës së Klinikës Juridike Penale të Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan

4.2 OAK një herë në vit do të shpallë konkursin për avokatët të cilët pro-bono do të angazhohen në klinikën juridike penale të Fakultetit Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan.

4.2 OAK në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit "Kadri Zeka", Gjiilan dhe Programin "Kërko Drejtësi" do të bëjnë përzgjedhjen e avokatëve që do të angazhohen pro-bono.

Neni 5

Kohëzgjatja e memorandumit

5.1. Kohëzgjatja maksimale e këtij memorandumi është deri më 31 maj 2018, duke filluar nga dita e nënshkrimit.



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEQA"

5.2 Ky memorandum mund të ndërpritet në mënyrë të menjëhershme nga cilado palë me një njoftim paraprak prej 15 ditësh.

5.3 Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 6

Gjuha dhe kopjet e Memorandumit të Mirëkuptimit

6.1 Ky MM është përgatitur në tri (3) kopje identike, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese të këtij dokumenti. Ky memorandum është përgatitur në gjuhën shqipe.



Nënshkruar në Gjilan, më _____

UNIVERSITETI GJILANIT UNIVERSITY OF GJILAN			
12.02.2019			
			Vlera
01	115		

Për Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeqa", Fakulteti Juridik

Emri: _____

Titulli: _____

Nënshkrimi:

Për Odën e Avokatëve

Emri: Shemsedin Piraj

Titulli: Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës- Dega në Gjilan

Nënshkrimi:

Për Programin "Kërko Drejtësi"

Emri: Edona Ahmetaj

Titulli: Udhëheqëse e Programit

Nënshkrimi:

